




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 25.09.2014

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 24.09.2014, pas shqyrtimit të Propozimit-buxhetit Nr. 524, të datës 10.09.2014, paraqitur nga Drejtoria për Financa, Buxhet dhe Pronë, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (b), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008) dhe nenin 27, shkronja (c), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M


1. Për aprovimin e Buxhetit të Planifikuar të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2015 në total prej 8,011,259.00€, i shpërndarë nëpër kodet e programeve dhe nën-programeve të kategorive ekonomike si vijon:
 - 1.1 Për paga dhe mëditje për 720 të punësuar në Administratë, Arsim dhe Shëndetësi është 4,140,000.00€;
 - 1.2 Për mallra dhe shërbime është 450,600.00€;
 - 1.3 Për shpenzime komunal është 169,400.00€;
 - 1.4 Për subvencione dhe transfere është 334,120.00€ dhe
 - 1.5 Për shpenzime në projekte kapitale është 2,917,139.00€.
2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë për Financa, Buxhet dhe Pronë.
3. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë për FBP dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Mr. Fadil Krasniqi





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 30.09.2014

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 24.09.2014, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 599, të datës 10.09.2014, paraqitur nga Kryetari i Komunës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 8, të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës Nr. 04/L-144, (Gazeta Zyrtare Nr. 35/2012), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (I), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 2 të Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 23/2013, për caktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

1. Për formimin e Komisionit për vlerësimin e ofertave, në përbërje prej shtatë anëtarëve, për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër me qira prej pesëmbëdhjetë (15) vite, të objekteve komunale për Çerdhe të Fëmijëve në fshatrat Bardh i Madh dhe Miradi e Poshtme.
 - 1.1 Milaim Berjani - Anëtar i Kuvendit të Komunës, përfaqësues i LDK-së;
 - 1.2 Sokal Duraku - Anëtar i Kuvendit të Komunës, përfaqësues i PDK-së;
 - 1.3 Elmi Shabani - Anëtar i Kuvendit të Komunës, përfaqësues i LVV-së;
 - 1.4 Violeta Xhigoli - Zyrtare e Prokurimit;
 - 1.5 Ejup Qyqalla - Shef për Shërbime Publike;
 - 1.6 Millanka Bojkoviç - Zyrtare e Lartë për Financa;
 - 1.7 Rexhep Gojnovci - Përfaqësues i Shoqërisë Civile.
2. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Anëtarëve të Komisionit, Drejtorisë për PUKGJ, Drejtorisë për Arsim, Drejtorisë për Administratë dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Mr. Fadil Krasniqi





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 30.09.2014

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 24.09.2014, pas shqyrtimit të Kërkesës Nr. 107, të datës 03.09.2014, paraqitur nga Këshilli i Bashkësisë Islame në Fushë-Kosovë, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

1. Lejohen mjetet financiare në shumë prej 165€, për mbulimin e shpenzimeve për çdo ceremoni të varrimit për qytetarët e komunës së Fushë-Kosovës, përfshirë të gjitha komunitetet fetare.
2. Sigurimi i mjeteve financiare sipas pikës një të vendimit nga buxheti i komunës, për periudhën trivjeçare është në kompetencë të Drejtorisë për Financa, Buxhet dhe Pronë.
3. Kryerja e procedurave tjera për zbatimin e vendimit është në kompetencë të Kryetarit të komunës, Drejtorisë për Financa, Buxhet e Pronë dhe Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Mjedis.
4. Për shpenzimin e mjeteve financiare të lejuar, përfaqësuesit e Bashkësisë Islame të Fushë-Kosovës dhe Kishës Ortodokse i raportojnë me shkrim Kuvendit të Komunës.
5. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Palëve,
Drejtorisë për FBP, Drejtorisë për SHPM dhe Arkivës.**


**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Mr. Fadil Krasniqi**





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 30.09.2014

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 24.09.2014, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 600, të datës 10.09.2014, paraqitur nga Kryetari i Komunës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 40, të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

1. Për formimin e Komitetit për Ndërmjetësim, në përbërje prej shtatë anëtarëve:
 - 1.1 Sabri Rexhepi - Anëtar i Kuvendit të Komunës, përfaqësues i LDK-së;
 - 1.2 Rezmi Shala - Anëtar i Kuvendit të Komunës, përfaqësues i LDK-së;
 - 1.3 Ridvan Krasniqi - Anëtar i Kuvendit të Komunës, përfaqësues i PDK-së;
 - 1.4 Aida Alimi - Anëtare e Kuvendit të Komunës, përfaqësuese e PDK-së;
 - 1.5 Shaban Ademi - Anëtar i Kuvendit të Komunës, përfaqësues i AKR-së;
 - 1.6 Qerim Gara - Anëtar i Kuvendit të Komunës, përfaqësues i PDAK-së;
 - 1.7 Miroslav Veličković - Anëtar i Kuvendit të Komunës, përfaqësues i GIS-it.
2. Detyrë dhe përgjegjësi e Komitetit për Ndërmjetësim është të punojë në ndërmjetësimin dhe zgjedhjen e konflikteve të qytetarëve të komunës së Fushë-Kosovës.
3. Komiteti për Ndërmjetësim për punën e tij i raporton Kuvendit të Komunës.
4. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Anëtarëve të Komitetit për Ndërmjetësim dhe Arkivës.


Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Mr. Fadil Krasniqi





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 30.09.2014

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 24.09.2014, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 599, të datës 10.09.2014, paraqitur nga Kryetari i Komunës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 5, të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, Nr. 04/L-144, (Gazeta Zyrtare Nr. 35/2012), nenin 14.2, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (I), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 1, nenin 4 të Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 23/2013, për caktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, nenin 3.2 dhe nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

1. Për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër me qira, në kohëzgjatje prej pesëmbëdhjetë (15) vite, të objektit Çerdhe për Fëmijë në fshatin Bardh i Madh, pronë e komunës, në sipërfaqe prej 158.32m², ngastra kadastrale Nr. 00815-0, në vendin e quajtur 'Selo Selo', Fleta Poseduese Nr. UL-72514010-00175, në Zonën Kadastrale Bardh i Madh.
2. Për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër me qira, në kohëzgjatje prej pesëmbëdhjetë (15) vite, të objektit Çerdhe për Fëmijë në fshatin Miradi e Poshtme, pronë e komunës, në sipërfaqe prej 158.32m², ngastra kadastrale Nr. 00196-1, në vendin e quajtur 'Livade Pashnjak', Fleta Poseduese Nr. UL-72514027-00149, në Zonën Kadastrale Miradi e Poshtme.
3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera, është në kompetencë të Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtorisë për Arsim dhe Drejtorisë për Administratë.
4. Mosfunksionalizimi i objekteve komunale sipas pikës një dhe dy të vendimit përmes dhënies në shfrytëzim me qira me destinim Çerdhe për Fëmijë i mbetet në kompetencë Kryetarit të Komunës ndërrimi i destinimit në Qendra Këshilluese për Veterinari.
5. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë për PUKGJ, Drejtorisë për Arsim, Drejtorisë për Administratë dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Mr. Fadil Krasniqi

